



## Fushata e Pastrimit të Mbetjeve dhe Menaxhimi i Mbetjeve në Bashkinë e Lezhës

### Konteksti i projektit

Iniciativa filloj me levizjen BELLS me ndërgjegjësimin dhe lobimin mbi çështjet mjedisore dhe më pas u ndoq nga projekti me titull “Fushata e pastrimit të mbetjeve dhe menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë e Lezhës” financuar nga Ambasada Hollandeze dhe zbatuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane dhe Bashkia Lezhë. Pasi faza fillestare u zbatua në mënyrë të suksesshme, ata gjithashtu përfshinë Zyrën e Bashkëpunimit Zvicerian përmes decentralizimit dhe programeve të zhvillimit. Kjo bëri të mundur përfshirjen e më tepër fondeve dhe asistencë teknike për të hartuar një skemë të re për menaxhimin e mbetjeve për ndarjen e mbetjeve të riciklueshme që në burim, ndërtimin e kapaciteteve si dhe ndërtimin e marrëdhënieve partneriteti publik-privat në nivel lokal si dhe ndërtimin e një qendre për riciklimin e mbetjeve.

### Objektivat e projektit dhe përfitimet e Bashkisë

1. Reduktimi me 37% ose rreth 6.500 tone mbetje të ngurta të destinuara për në landfill, si dhe instalimin e një sistemi për mbledhjen e diferencuar dhe ndarjen e mbetjeve të riciklueshme.
2. Banorët janë të ndërgjegjësuar mbi efektet e jashtme të mbetjeve si dhe mbi mbledhjen e diferencura.
3. Përmirësimi i performancës financiare të bashkisë për shërbimin e pastrimit dhe menaxhimin e mbetjeve.
4. Përmirësimi i aktiviteteve të marketingut për të siguruar produkte të riciklueshme.



Bashkia do të përfitojë gjithashtu nga vizioni, qëllimet dhe objektivat e përcaktuara qartë në Planin e Menaxhimit të Mbetjeve, të përgatitura nga stafi i IKU, si dhe nga plani i veprimit që do t'i udhëheq ata në 5 vitet e ardhshme për të përmirësuar shërbimet e tyre në sistemin e menaxhimit të mbetjeve.

### Aktivitete e projektit

Ekzistojnë shumë aktivitete që e bëjnë projektin të vlefshëm, duke filluar me një vit fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi me banorët në Lezhë, ngritjen e kapaciteteve institucionale, përgatitjen e planit të menaxhimit të integruar pesë vjeçar, bazuar në kornizat afatmesme buxhetore të bashkisë.

Të gjitha aktivitetet janë kryer duke përfshirë institucionet publike dhe kompanitë e biznesit si dhe publikun në përgjithësi, në demonstrimin e aktiviteteve në mënyrë që të nxitet besimi dhe të tregohet se plani i ri për menaxhimin e mbetjeve mund të funksionojë nëse ka pjesëmarrje nga publiku në njërin anë, dhe efektivetit institucional nga ana tjetër.

### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.

## Qendra për riciklimin e mbetjeve

Qendra për riciklimin e mbetjeve është ndërtuar me mbështetjen e Institutit të Kërkimeve Urbane si një pjesë integrale e të gjithë Planit të Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë e Lezhës.

Ndërtimi i qendrës është bërë e mundur nga një financim ipërbashkët i Bashkëpunimit Zviceran/dldp, Bashkia e Lezhës dhe Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri.

Qendra për riciklimin e mbetjeve është projektuar që të ofrojë shërbimin për zgjedhjen e mbetjeve të riciklueshme të cilat mbledhen përmes sistemit të mbledhjes së diferencuar që është instaluar në qytetin e Lezhës në kuadër të projektit “Fushata e pastrimit të mbetjeve dhe menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë e Lezhës”.

Projekti synon të mbështes riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve të parashikuara për t’u dërguar në landfillin e Bushatit.

Bashkia e Lezhës ka projektuar një hapsirë toksore dhe një ndërtesë me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup> nën pronësin e tij. Vizibiliteti dhe funksionaliteti i studimit, duke përfshirë specifikimin e pajisjeve si dhe një plan rikonstruksioni janë përgatitur fillimisht nga IKU në bashkëpunim me stafin e specializuar të bashkisë.

Stafi ka përcaktuar formatin e menaxhimit duke përdorur një modul funksionimi partneriteti publik-privat.

### FAKTET KRYESORE

#### DONATORËT:

- ✓ Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri
- ✓ DLDP

#### KOHËZGJATJA:

2011-2013

#### PËRFITUESIT:

- ✓ Bashkia Lezhë

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtoreshë Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: [uri@uri.org.al](mailto:uri@uri.org.al)

#### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.